



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
 			
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo			
ARKIV ARHIV ARCHIVE			
Nr. Prot. Broj. prot. No. no	Nr. i faq. Br. str. No. page	Data: Datum: Date:	
73	3	04.02. 2026	
PRISHTINE - PRIŠTINA - PRISTINA			

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

Oda e Infermierëve mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës (OIK), mbështetur në Ligjin Nr. 04/L-150 për Odave Profesionistevve shëndetësorë nenit 2, pika 1.5 shpallë:

SHPREHJE E INTERESIT PUBLIK

Për ofrimin e sigurimit të jetës dhe shëndetit për anëtarët e Odës së Infermierëve mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësorë të Kosovës (OIK)

1. Autoriteti Kontraktues

Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK), është organizatë profesionale e themeluar me Ligjin Nr. 04/L-150 për Odave Profesionistevve shëndetësorë, në mbështetje të nenit 2, pika 1.5 të këtij ligji ku përcakton mbrojtjen e interesave profesionale, sociale dhe ekonomike të anëtarëve, shpall **Shprehje Interesi Publik** për përzgjedhjen e kompanive të sigurimit për ofrimin e sigurimit të jetës dhe shëndetit për anëtarët e saj.

Ky aktivitet realizohet në kuadër të planit strategjik të OIK për mbështetje shëndetësore dhe sociale të anëtarëve përmes skemave të sigurimit.

2. Qëllimi i Shprehjes së Interesit

Qëllimi i kësaj shprehjeje interesi është përzgjedhja e një kompanie të licencuar të sigurimeve, e cila do të ofrojë një **paketë bazë të sigurimit të jetës**, si dhe shërbimeve shëndetësore të përcaktuar për të gjithë anëtarët e OIK, në përputhje me mundësitë buxhetore të Odës.

Për sqarim: Pako e sigurimeve në fjalë është pako e shërbimeve shëndetësore specifike vetëm për disa kategori të sëmundjeve dhe nuk është e barasvlershme me pakot e sigurimeve shëndetësor.

3. Përshkrimi i Paketës Bazë të Sigurimit

Paketa bazë e sigurimit synon të mbulojë këto rreziqe dhe përfitime:

- I. Vdekje si pasojë e aksidentit
- II. Vdekje si pasojë e sëmundjeve profesionale
- III. Vdekje natyrale (si pasojë e sëmundjeve të ndryshme)
- IV. Paaftësi / invaliditet si pasojë e aksidentit
- V. Kompensim për sëmundje të rënda, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Atak kardiologjik
- Sulm në tru
- Sëmundje onkologjike
- Dështim kronik i veshkave
- Ndërhyrje kardiokirurgjike (kirurgji e hapur, by-pass i aortës, implantim i valvulave)
- Verbëri dhe/ose shurdhëri
- Sklerozë multiple
- Djegje të shkallës së tretë
- Paralizë
- Sëmundja e Alzheimerit
- Gjendje kome
- VI. Qëndrim spitalor
- VII. Thyerje të kockave si pasojë e aksidentit
- VIII. Kirurgji kozmetike si pasojë e aksidentit

4. Shumat Orientuese të Kompensimit

Shumat e mëposhtme paraqesin nivele orientuese të mbulimit, sipas tre varianteve të mundshme që synon OIK:

Nr.	Përshkrimi	Varianti 1 (€)	Varianti 2 (€)	Varianti 3 (€)
1	Vdekje nga aksidenti	5,000	3,500	2,500
2	Invaliditet nga aksidenti	2,000	1,500	1,000
3	Paaftësi nga lëndimi në punë	4,000	3,000	2,000
4	Sëmundje onkologjike	5,000	4,000	3,000
5	Vdekje nga sëmundje profesionale	5,000	3,500	2,500
6	Vdekje natyrale (deri në moshën 65 vjeç)	1,500	1,000	750
7	Sëmundje të rënda (pika V)	1,000	750	500
8	Qëndrim spitalor 7–14 ditë	150	100	75
9	Qëndrim spitalor 15–21 ditë	200	150	100
10	Qëndrim spitalor mbi 22 ditë	250	200	150
11	Kirurgji kozmetike nga aksidenti	300	250	150

5. Mbulimi për Anëtarët e Familjes

E drejta e përfitimit nga kjo paketë sigurimi u ofrohet edhe anëtarëve të ngushtë të familjes së anëtarit të OIK (bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët deri në moshën 15 vjeç), në masën 50% të shumës së përfitimit të përcaktuar për anëtarin e OIK.

6. Kushtet e Financimit dhe Përfitimit

OIK mbulon shpenzimet e sigurimit në baza vjetore, sipas paketës së përzgjedhur.

Kompania e sigurimeve duhet të kalkulojë dhe propozojë koston vjetore për anëtar, ndërsa pagesa realizohet nga OIK në fund të çdo viti, bazuar në numrin aktual të anëtarëve.

Të drejtën e përfitimit e kanë të gjithë anëtarët e OIK, përfshirë sektorin publik, privat, të papunësuarit dhe pensionistët, me licencë valide profesionale.

7. Afatet dhe Zbatimi

Afati për dorëzimin e shprehjeve të interesit dhe ofertave është deri me datën: **20.02.2026**

Afati maksimal për përzgjedhjen e kompanisë së sigurimit është deri me datën: **25.02.2026**

Fillimi i planifikuar i implementimit të paketës së sigurimit është deri me datën: **01.07.2026**

Pas përzgjedhjes së kompanisë fituese, do të formohen grupe të përbashkëta punuese nga OIK dhe kompania e sigurimeve, të cilat do të përcaktojnë kriteret dhe procedurat e detajuara të realizimit të përfitimeve nga paketa e sigurimit.

8. Procedurat e Kompensimit dhe Kontrolli

OIK synon që procedurat për përfitimin e sigurimit të jenë të thjeshta, transparente dhe lehtësisht të zbatueshme për komunitetin e anëtarëve, duke vendosur njëkohësisht mekanizma mbrojtës për parandalimin e keqpërdorimeve të mundshme.

Kompania e sigurimeve duhet të prezantojë procedura të qarta dhe afate të sakta për trajtimin dhe realizimin e kompensimeve për anëtarët e OIK.

9. Informata Shtesë

Për çdo sqarim shtesë lidhur me këtë Shprehje Interesi Publik, palët e interesuara mund të kontaktojnë Odën e Infermierëve të Kosovës (OIK) përmes adresës zyrtare të email-it: info@oik-ks.org.

Afati për dorëzimin e ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen më së voni deri më 20.02.2026, ora 15:00, përmes email apo në formë fizike.

Adresa për dorëzimin e ofertave:

Zyra e Odës së Infermierëve të Kosovës (OIK)
Rruga Holger Pedersen, Prishtinë, Kosovë
Ndërtesa *Vëllezërit Asllani*

Për çdo pyetje ose kërkesë shtesë, ju lutemi të kontaktoni në adresën: info@oik-ks.org.